

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“DM & KN” SH.P.K

Neni 1

Emërtimi i shoqerise

Z.Mariglen Deçolli me ID I60527052I dhe Zj.Klodiana Sinani me ID:I36217063T ,me seli ne Vlore, kane rene dakort te themelojne dhe te jene ortake te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar: “DM & KN ” shpk. Shoqeria eshte person juridik dhe ushtron veprimtari ne ne baze te Ligjit Nr.9901 ,date 14.04.2008“ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Neni 2

Selia e shoqerise

Selia e shoqërisë “DM & KN” shpk është ne adresen : VLORE Lagja Hajro Cakerri,Rruga Musa Cakerri Pallati nr 2, Kati 1 prane BKT Vlore 9401. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarise

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin tregtar do te jete subjekt i te drejtes shqiptare deri me 14.02.2034. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të ortakut te shoqerise.

Neni 4

Objekti

Objekti i shoqërisë do te jete si vijon :

Sherbime publike, sherbime funerale, mirmbajtje e varrezave publike dhe te deshmoreve, dekor e gjeberim, prodhim e montim i qivureve, arkivoleve, kurorave etj. Ne fushen e projektimit dhe zbatimit per ndertime civile, industriale, turistike, punime dheu, murature betoni, punime restaurimi, vepra beton armeje te vecanta, sistemime komunale.Punime te inxhinierise se mjedisit

Neni 5

Kapitali i regjistruar

Vlera e kapitalit te kontribuar dhe i regjistruar ne shoqëri është 100.000 leke (Njeqind mije) i ndare ne 2 pjese , 1 pjese zoterohet nga zMariglen Deçolli ne masen 50% te pjeseve te kapitalit, e vleresuar ne vleren 50 000 leke , dhe 1 pjese nga zj.Klodiana Sinani ne masen 50% te pjeseve te kapitalit e vleresuar ne vleren 50 000 leke.

Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë .

Neni 6

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të shoqërisë "DM & KN" shpik e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

kontributit në kapitalin e shoqërisë;

shit-blerjes;

trashëgimisë;

dhurimit

çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Kalimin e kuotave, veçanërisht miratohen në mbledhjen e asamblesë të shoqërisë ku të drejten e parablerjes e kanë ortakët e shoqërisë

Neni 7

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë

Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a) për caktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështjetë tjera të parashikuar nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës

3. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur

shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një here në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë njëvlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 9

Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime,

pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kërkesa nga ortakët e pakicës

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve tëposaçme në rendin e ditës.

Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhetë caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të këtij ligji.

4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar

Neni 11

Përfaqësimi në asamble

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për

çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite

Neni 13

Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 14

E drejta e votës

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

2. Statuti mund të parashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) transmetimin e mbledhjes së asamblesës së përgjithshme në kohë reale;

b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;

c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar

identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Neni 15

Përfashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson

Neni 16

Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në proces verbal.

Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të proces verbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Proces verbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonëse 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të process verbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Neni 17

Drejtimi dhe administrimit

Shoqëria tregtare "DM & KN" shpk do të drejtohet nga një administrator që emrohet me vendim të Asamblesë të Shoqërisë. Administratori i shoqërisë për periudhën 5 vjetecare duke filluar nga data e sotme deri me datën 13.02.2029 do të jetë Z. Mariglen Deçolli

Administratori ka të drejtë e të detyrohet të :

Kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare të vendosur nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.

Perfaqesoje shoqerine tregtare

Kujdeset per mbajtjen sakte e te regullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise Pergatit dhe nenshkruan bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe sebashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ,I paraqet keto perpara asamblea e pergjithshme e shoqerise per miratim,

Krijon nje system paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,

Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme sic parashikohen ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit

Raporton para asamblese te pergjithshme e shoqerise ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare, Administratori do te shperblehet sipas percaktimit te asamblese se pergjithshme te shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit nr 9901 date 14.04.2008.

Neni 18

Kontrolli i brendshem

Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te regjistruar , i cil eshte pergjegjes perpara shoqerise per demet qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne rregull e detyres se tij

Neni 19

Bilancet dhe te ardhurat

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise do te mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti, pervec rasteve e urdherave te vecanta te ortakut te vetem te saj.

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxiret bilanci kontabel dhe rezultati ekonomik humbje/fitim.

Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 mars te viti pasardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjesa qe mbetet i jepet per perdorim asamblese se pergjithshme te shoqerise.

Neni 20

Shperberja e shoqerise

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe cfardo shkaku.Ne rast shkrirje para afatit te shoqerise, Asamblea e pergjithshme e shoqerise vendos mbi menytrat e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdator duke i percaktuar dhe detyrat.

Ne rasti e likujdimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi "shoqeri ne likujdim "

Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit "

Neni 21

Dispozitat perfundimtare



Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit "

Neni 21

Dispozitat perfundimtare

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut do i referohet plotesimeve nga asambleja e pergjithshme e shoqerise.


Shoqeria "DM & KN" shpk do te jete subjekt i te drejtes shqiptare dhe do ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne pergjithesi ,normat e ketij statuti dhe te aktit themelues bashkangjitur .

Ky statut nenshkruhet nga ana e ortakeve /ose perfaqesuesve te tyre me pokure, ne daten 14 Shkurt 2024

PER ASAMBLENE E SHOQERISE "DM & KN" shpk

ORTAK TE SHOQERISE

KLODIANA SINANI

Klodiana Sinani


MARIGLEN DEÇOLLI

Mariglen Deçolli
